

## 3.6 HIDROIZOLUES PËR BETONIN

### IZOTRATE



Njësia matëse	copë/paletë	Konsumi	Ngjyra/specifikime të tjera
20 kg/thes	54 cp/paletë	0.75 kg/m <sup>2</sup>	Gri



#### IZOTRATE

Është llaç me bazë çimento i cili aplikohet me furçë. Ai përmban kimikate aktive, të cilët kur bien në kontakt me lagështinë dhe hidroksidin e gëlqeres hyjnë në reaksion duke formuar kristale të patretshme. Këto kristale bllokojnë kapilarët dhe plasaritjet e shkaktuara në brendësi nga tkurrjet dhe bymimet e betonit, duke parandaluar kështu absorbimin e mëtejshëm të ujit. IZOTRATE ofron një sërë avantazhesh, ndër të cilat përmendim:

- Qëndron në mënyrë të përhershme aktiv duke mbrojtur në mënyrë permanente konstruksionin nga prania e ujit.
- Lidhet në perfeksion me betonin duke i dhënë cilësitë e dëshiruara.
- Është në gjëndje të mbyllë plasaritje deri në 400 mikron, edhe nëse ato shfaqen mbas aplikimit.
- Në rastet e dëmtimit të sipërfaqes së betonit apo të shtresës hidroizoluese nuk kemi ndikim në hidroizolim të konstruksionit.
- Mbron konstruksionet e përforcuara me çelik nga korrodimi.
- Përdoret për hidroizolim të depozitave të ujit ose të sipërfaqeve që janë në kontakt të drejtpërdrejtë me ujin.
- Nuk ndikon në proceset kimike të elementëve të tjerë që ndodhen në beton.
- Përdoret lehtësisht dhe me kosto të ulët.
- Ky produkt është klasifikuar si një shtresë për mbrojtjen e betonit.

#### FUSHA E APLIKIMIT

Hidroizolimi i sipërfaqeve të betonit në rastet kur kemi praninë e lagështisë dhe në rastet kur kemi trysni uji. IZOTRATE është i përshtatshëm për hidroizolim të bodrumeve, pusetave, depozitave të ujërave të zeza si dhe kryesisht të themeleve.

#### PËRGATITJA E SUPORTIT

Suporti duhet të jetë i pastruar, pa praninë e pluhurave dhe shtresave të vajrave. Për sipërfaqe shumë të lëmuara është e nevojshme paratrajtimi me ujë me presion për ashpërsim. Në vendet ku kemi praninë e rrjedhjes së ujit duhet të bëhet fillimisht izolimi i tij.

Në rastet kur kemi plasaritje të dukshme në sipërfaqen e betonit, fillimisht duhet të bëhet mbyllja e tij dhe të pastrohet sipërfaqja. Nëse sipërfaqja ku aplikohet ka copa telash të dalë, ato duhet të priten nga 2 deri në 4 cm thellësi dhe pasi vrima e krijuar të mbyllet aplikohet produkti.

#### APLIKIMI

IZOTRATE shtohet gradualisht në sasinë e kërkuar të ujit nën një përzjerje të vazhdueshme derisa të formohet një masë viskoze e përshtatshme për tu aplikuar me furçë. Sipërfaqja ku do të aplikohet duhet të jetë pak e lagur por nuk duhet të ketë sasi uji të ndenjtur. Produkti duhet të aplikohet në dy shtresa të cilat nuk duhet të jenë më shumë se 1 mm të trasha për të shmangur plasaritjet e mundshme. Shtresa e dytë aplikohet për aq kohë sa shtresa e parë është akoma e njomë. Në rastet kur shtresa e parë është tharë plotësisht duhet të bëhet lagia e sipërfaqes me ujë para aplikimit të shtresës tjetër. Gjithashtu, pas mbarimit të aplikimit, sipërfaqja duhet të spërkatet me ujë për 2 – 3 ditët në vazhdim në mënyrë që shtresa hidroizoluese të mbetet pak e njomë duke i përforcuar vetitë gradualisht. Lagia e sipërfaqes duhet të bëhet gradualisht pas momentit që IZOTRATE ka filluar të forcohet. Kjo bëhet në mënyrë që të shmangen dëmtimet. Zakonisht sipërfaqja duhet të spërkatet 2 – 3 herë me ujë në ditë. Sipërfaqja përfundimtare duhet të mbrohet nga shiu dhe ngrica.



**TË DHËNAT TEKNIKE**

Pamja	Pluhur
Ngjyra	Gri
Dëndësia përzierjes	1.3 gr/cm <sup>3</sup>
Djegshmëria	I padjegshëm
Raporti i Përzierjes	
Me spatull	6-7 L ujë për 20 kg Izotrata
Me furçë	7-8 L ujë për 20 kg Izotrata
pH i përzierjes	12
Kohëzgjatja e përzierjes	3-4 orë
Koha e aplikimit midis	Pas 1.5 orësh në 23°C
2 duarve	
Trashësia maksimale për dorë	1 mm
Rezistenca në presion pozitiv	7 atm sipas DIN 1048

**TË DHËNAT PËRFUNDIMTARE**

Aftësia ngjitëse në beton	≥ 3 N/mm <sup>2</sup>
Rezistenca ndaj lagështisë	Shumë e mirë
Rezistenca ndaj amortizimit	Shumë e mirë
Përshkueshmëria	I papërshkueshëm

**JETËGJATËSIA DHE RUAJTJA**

12 muaj nga data e prodhimit nëse ruhet në ambalazh origjinal dhe mbrohet nga ngricat dhe ekspozimi i drejtpërdrejtë në diell.

